

**SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së
ŽALBENO VEĆE KAI**

GSK-KPA-A-137/12

**Prishtinë
12 prill 2013**

Në çështjen juridike të:

H.B.

Paraqitësi i kërkesës / Pala ankuese

Kundër

K.A.

Pala përgjegjëse në kërkesë/Pala përgjegjëse në ankesë

Kolegji i Apelit të AKP-së, i Gjykatës Supreme të Kosovës, i përbërë nga gjyqtarët: Anne Kerber, Kryetare e Kolegjit, Elka Ermenkova dhe Sylejman Nuredini, anëtarë, duke vendosur me ankesën e ushtruar kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KKPK/D/A/152/2012 (lënda e regjistruara në AKP me numër KPA17897), i datës 19 prill 2012, pas shqyrtimit të mbajtur më 12 prill 2013, mori këtë:

AKTGJYKIM

- 1- Anulohet vendimi i Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KKPK/D/A/152/2012 , i datës 19 prill 2012, sa i përket lëndës së regjistruara në AKP me numër KPA17897.
- 2- Hedhet poshtë kërkesa e H. B. për të drejtën e shfrytëzimit mbi banesën në pronësi shoqërore prej 38 m², që gjendet në Prishtinë, rr "Beogradska" nr: 12, sepse është jashtë kompetencave të KKPK-së.
- 3- Obligohet pala ankuese që të paguaj shpenzimet e procedurës në shumën prej 60 € (gjashtëdhjetë euro) dhe ato duhet të paguhet në buxhetin e Kosovës brenda afatit prej 90 (nëntëmbëdhjetë) ditësh nga dita e dorëzimit të këtij aktgjykimit nën kërcënimin e përmbarrimit të detyrueshëm.

Përmbledhja e çështjeve procedurale dhe faktike:

Me 29 janar 2007, H. B. si mbajtës i të drejtës së pronës ka paraqitur kërkesë pranë Agjencisë Kosovare të Pronave (AKP) duke kërkuar vërtetimin e të drejtës së shfrytëzimit dhe ri-posedimin të një banesës në sipërfaqe prej 38 m², që gjendet në Prishtinë, rr" Beogradska" nr: 12. Paraqitësi i kërkesës theksoi se banesa i ishte ndarë atij për shfrytëzim të përkohshëm nga Komuna e Prishtinës.

Në mbështetje të kërkesës së vetë ai i parashtroi AKP-së dokumentet në vijim:

- Vendimin për ndarje nr: 07. Br. 360, të datës 14 shtator 1995, të lëshuar nga Sekretariati për Urbanizëm dhe çështje banesore komunale- Komuna e Prishtinës, që i ndanë paraqitësit të kërkesës banesën/apartamentin e pretenduar.
- Kërkesa e Sekretariatit për Urbanizëm të Komunës së Prishtinës nr. 032. Br. 352-675, të datës 21 nëntor 1997 për Distribucionin e "Elektroprivreda" në Prishtinë, në lidhje me çështjet e energjisë elektrike për banuesit në banesat e zonës në të cilën ka jetuar po ashtu edhe paraqitësi i kërkesës;
- Letërnjoftimin e datës 27 gusht 1996, të lëshuar në Republikën e Malit të Zi.

Në bazë të raportit të verifikimit të 11 prillit 2007, AKP-ja ka verifikuar Vendimin Administrativë Nr. 07, Br. 360, të datës 14 shtator 1995.

AKP-ja ka organizuar njoftimin e kërkesës. Në fakt AKP-ja e ka vizituar pronën tri herë, me 7 korrik 2008, 14 korrik 2008, dhe 21 korrik 2008. Ekipi njoftues ka shkuar tek vendi ku pretendohet se gjendej prona si dhe ka vendosur shenjen në derën e banesës së pretenduar, që tregonte se prona ishte objekt i kërkesës si dhe pala e interesuar duhet ta parashtroj përgjigjen e vet brenda 30 ditësh.

Gjatë njoftimit ishte gjetur se prona e kërkuar ishte e zënë nga personi i panjohur i cili nuk ishte i pranishëm.

Me 18 gusht 2008 pala përgjegjëse në kërkesë K. A. është paraqitur tek AKP-ja dhe ka nënshkruar kërkesën për të marr pjesë në procedurë. Ajo ka pohuar se ajo e ka lejen nga pala e tretë për shfrytëzimin e pronës.

Në mbështetje të kërkesës së vetë ajo në mes të tjerave i parashtroi AKP-së dokumentet në vijim:

- Listën zyrtare të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale e cila tregon listën e kriterëve sipas së cilave një personi i jepet strehimi;
- Kopjen e kartelës sociale nr. 19/4877, me të cilën pala përgjegjëse në kërkesë merr shumën e caktuar të parave si ndihmë sociale;
- Kërkesën me shkrim nga ana e palës përgjegjëse në kërkesë drejtuar Sektorit të Pronës në Komunën e Prishtinës, të datës 28 shtator 2004, ku kërkohet strehimi;
- Përgjigje/ informim nr: 010/46-1046, të datës 28 nëntor 2004, të lëshuar nga Drejtoria për Pronë dhe Financa- Sektori i Pronës në Komunën e Prishtinës, që në mesin e të tjerave tregon se prona e pretenduar është pronë shoqërore dhe shfrytëzuesi i saj është Komuna e Prishtinës;
- Vërtetimin nr: 973/04, të datës 18 gusht 2004, të lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Administratës- Sektori për Bashkësi Lokale, që tregon se pala përgjegjëse në kërkesë është banore e Bashkësisë Lokale Nr: 1;
- Faturën e pagesës së Tatimit në Pronë, të datës 9 shkurt 2005, të lëshuar nga Komuna e Prishtinës, që tregon se pala përgjegjëse në kërkesë- K. A. është tatim pagues. Ky dokument nuk identifikon ndonjë pronë (po ashtu nuk ka elemente identifikuese që i referohen pronës së pretenduar).

Me 18 gusht 2009, paraqitësi i kërkesës me anë të letrës së vet drejtuar AKP-së, ka shpjeguar se pala përgjegjëse në kërkesë (K.A.) është personi që ilegalisht e ka zënë pronën. Paraqitësi i kërkesës ka kërkuar prej AKP-së dëbimin.

Me 18 janar 2012, Komuna e Prishtinës e ka pranuar njoftimin e dërguar për pjesëmarrje në procedurën pranë AKP-së.

Ne 19 prill 2012, KKPK-ja me vendimin e saj KKPK/D/A/152/2012 e ka refuzuar kërkesën e paraqitësit të kërkesës ngase ai nuk e ka dëshmuar të drejtën e pronës ndaj pronës së pretenduar.

Vendimi i KKPK-së i është dërguar paraqitësit të kërkesës me 5 tetor 2012, ndërsa po i njëjti i është dërguar palës përgjegjëse në kërkesë me 25 tetor 2012.

Me 9 tetor 2012, paraqitësi i kërkesës (tutje si parashtruesi i ankesës) ka paraqitur ankesë pranë Gjykatës Supreme. Ai ka këmbëngulur se dispozitivi i vendimit është në kundërshtim me arsyetimin e vendimit dhe se është marr në shkelje të së drejtës materiale. Për më tepër, ai ka theksuar se vendimi është marrë në vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike.

Ankesa i është dërguar palës përgjegjëse në ankesë (tutje si pala përgjegjëse në ankesë). Ajo nuk është përgjigjur.

Arsyetimi ligjor:

Ankesa është e pranueshme. Ajo është paraqitur me kohë.

Sipas nenit 12.1 të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2006/50 e ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-079, pala ka të drejtë të paraqesë ankesë “...*brenda tridhjetë (30) ditëve nga njoftimi i palëve nga Agjencia Kosovare e Pronës për vendimin e Komisionit mbi ankesën*”.

Vendimi i KKKPK/D/A/152/2012 i është dërguar parashtruesit të ankesës me 5 tetor 2012. Më pas ai me datë 9 tetor 2012 ka parashtruar ankesën e tij kundër vendimit të lartcekur. Ankesa është e pranueshme ngase kjo datë bie brenda afatit 30 ditor.

Sipas nenit 12.4 të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2006/50 e ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-079, AKP-ja ia ka dërguar ankesën palës përgjegjëse në ankesë. Ajo nuk është përgjigjë.

Megjithatë, kërkesa nuk është në kompetencë të KKKPK-së ngase e drejta e shfrytëzimit, që pretendohet nga ana e parashtruesit të ankesës/paraqitësit të kërkesës lidhet me pronën e cila ka qenë pronë shoqërore, jo private.

Sipas nenit 2.1 të Udhëzimit Administrativ të UNMIK-ut 2007/5, për implementimin e rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/50 mbi zgjidhjen e kërkesave lidhur me pronën e paluajtshme private, përfshirë pronat bujqësore dhe ato komerciale, të ndryshuar me ligjin nr. 03/L-079, tutje si Udhëzimi administrativ (UD) “çdo person i cili ka pasur të drejtë të pronësisë, posedim ligjor apo **çfarëdo të drejthe tjetër ligjore të shfrytëzimit të pronës së paluajtshme private**, i cili në momentin e paraqitjes së kërkesës nuk mund të ushtrojë të drejtën e tij/saj pronësore për shkak të rrethanave që janë të ndërlidhura drejtpërsëdrejti apo që janë pasojë e konfliktit të armatosur 1998/1999, ka të drejtë rikthimi të së drejtës pronësore, si bartës i së drejtës pronësore”. banesa në fjalë nuk ka qenë kurrë pronë e

paluajtshme private dhe në këtë drejtim është jashtë fushëveprimit të zbatimit në procedurën pranë AKP-së.

Prej dokumenteve në dosje është vërtetuar se banesa ishte në pronësi shoqërore dhe Komuna e Prishtinës ka qenë ndarësi i të drejtës në pronë (Shfrytëzimi i banesave shoqërore, të drejtat e banuesit dhe mbajtësit të së drejtës në ndarje ishin rregulluar me Ligjin mbi Marrëdhëniet Banësore- GZ e KSK, Nr. 11/83, 29/86, 42/86). Në vitin 1995 banesa në fjalë i ishte ndarë përkohësisht paraqitësit të kërkesës.

Nuk ka prova nëse paraqitësi i kërkesës më pas ka lidhur kontratë mbi shfrytëzimin në përputhje me nenin 37 të Ligjit të Banimit.

Pa marr parasysh, edhe nëse paraqitësi i kërkesës e ka pas të drejtën e banimit do të ishte e pa rëndësishme ngase vërtetimi i një drejtë të tillë **mbi pronat shoqërore** në këtë procedurë nuk bie brenda kompetencave të KKKP-së, përkatësisht Kolegjit të Apelit të AKP-së.

Edhe pse, KKKP-ja si organ gjysmë-gjyqësor duke vendosur mbi meritat e kërkesës tashmë e ka pranuar kompetencën e saj, Gjykata *ex officio* vlerëson nëse rasti bie brenda fushëveprimit të kompetencave të saj (neni 195.1, (b)) të Ligjit të Procedurës Kontestimore).

Përderisa ankesa është bërë ndaj vendimit të KKKP-së i njëjti është dashtë që të anulohet dhe që kërkesa të hidhet poshtë (Neni 11.4 (a) të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2006/50 e ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-079), dhe jo që të refuzohet ashtu siç është vendosur në vendimin grupor KKKP/D/A/152/2012. Në fakt, vendimi individual, në lidhje me kërkesën e posaçme (KPA17897) e përdor termin “ hidhet poshtë”, megjithatë, vendimi grupor ka të bëjë me meritat e kërkesës, prandaj duhet të anulohet.

Shpenzimet e procedurës:

Në bazë të Shtojcës III, nenit 8.4 të Urdhërësës Administrative (UA) 2007/5 e ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-079, palët lirohen nga shpenzimet e procedurës para Sekretarisë Ekzekutive dhe Komisionit. Megjithatë, një përjashtim i tillë nuk është i paraparë për procedurat para Kolegjit të

Apelit. Si pasojë, regjimi normal i pagesës së taksës gjyqësore të paraparë më Ligjin mbi Taksat Gjyqësore (Gazeta Zyrtare e KSAK-së, 3 tetor 1987) dhe me UA Nr. 2008/2 të Këshillit Gjyqësor të Kosovës mbi unifikimin e taksave gjyqësore janë të vlefshme për procedurat para Kolegjit të Apelit.

Kështu që, tarifat e mëposhtme të gjykatës zbatohen për procedurat aktuale të apelit:

- Taksa nga tarifa gjyqësore për paraqitjen e ankesës (neni 10.11 i UA 2008/2): 30 €
- Taksa nga tarifa gjyqësore për nxjerrjen e aktgjykimit (10.1, 10.15 dhe 10.21 të UA 2008/2) duke pas parasysh se vlera e pronës në fjalë ka mund që për afërsisht të vlerësohet 7.600 €, dhe se vlera e shpenzimeve nuk mund të jetë më shumë se € 30: 30 €.

Këto taksa gjyqësore duhet të merren përsipër nga pala ankuese e cila ka humbur rastin dhe që ka paraqitur kërkesë të palejueshme. Sipas nenit 46 të Ligjit mbi Taksat Gjyqësore, afati për pagimin e taksës nga personi i cili jeton jashtë është midis 39 dhe 90 ditësh. Neni 47.3 parasheh që në rast se pala nuk i paguan taksat brenda afatit të dhënë, pala duhet të paguajë një gjobë prej 50% të shumës së gjobës. Në rast se pala nuk i paguan taksat brenda afatit të dhënë, atëherë bëhet zbatimimi i detyrueshëm i pagesës.

Këshillë juridike

Në përputhje me Nenin 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin 03/L-079, ky aktgjykim është i formës së prerë e i plotfuqishëm dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve juridike të rregullta apo të jashtëzakonshme.

Anne Kerber, Kryetare e Kolegjit, EULEX

Sylejman Nuredini, Gjyqtar

Elka Filcheva-Ermenkova, Gjyqtare e EULEX-it

Urs Nufer, Referent i EULEX-it